



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË

VENDIM

Nr. 2 datë 21.02.2025

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 15 datë 17.02.2020, Neni 27, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 21/02/ 2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 27/02/2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Mjaftoni ZERAJ

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Vladimir BAKIAJ

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Dino Selimi





BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2 prot.

Tepelenë, më 21.02.2025

Procesverbal

I mbajtur sot me datë 21.02.2025 ora 10.00 në zyrën e këshillit bashkiak me Kryesinë e Këshillit pët të diskutuar rendin e ditës dhe datën e mbledhjes

Marrin Pjesë:

1. Arben Gumeni
2. Dino Selimi
3. Mjaftoni Zeraj

Rendi i ditës së mbledhjes së këshillit në baze të p/vendimeve që cdo drejtori ka dërguar tek Sekretari i Keshillit.

Data e mbledhjes;

K/Këshillit Z. Arben Gumeni sygjeron që datë për mbledhjen e radhës te lihet datë 27.02.2025.

U miratua data e mbledhjes datë 27.02.2025.

1. Rendi i ditës si më poshtë: Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluara datë 30.01.2024.
3. **Projektvendim:** : “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Janar 2025”.
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Janar 2025”.
5. **Projektvendim:** “Për miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit për vitin 2024”.
6. **Projektvendim:** “Për detajimin e plan - buxhetit për të ardhurat e trashëguara nga viti 2024, dhe disa ndryshime në vendimin e këshillit të bashkisë nr. 72 datë 27.11.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”.
7. **Projektvendim:** “Heqje nga fondi kullosor i Bashkisë Tepelenë”.

8. **Projektvendim:** “Për azhurnimin e hartës kadastrale për pasuritë nr. 87/25 ZK 3661 ndodhur në fshatin Turan, Bashkia Tepelenë”.
9. **Projektvendim:** “Për administrimin e efekteve të raportit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe raportit të grupit të punës lidhur me pasuritë nr. 24/88-ND1, 24/88-ND2, 24/91-ND1, 24/91-ND2, 24/88-ND1, 24/88-ND2, 24/95-ND, në referencë të vendimit Nr. 16, datë 27.02.2024 “Për miratimin e nisjes së procedurave nga Bashkia Tepelenë për zhvillimin e pasurive nr. 24/83, 24/88, 24/90, 24/91, 24/95, 24/110, 24/117, 24/19, 24/120, zona kadastrale nr. 3574, pronësi shtetërore, në përdorim/administrim të Bashkisë Tepelenë”.
10. Raport për vendimarrjen dhe performancën e Këshillit të Bashkisë Tepelenë për vitin 2024.
11. Çështje të tjera.

Të pranishmit e miratuan këtë rend dite.

K/Këshillit falenderon të pranishmit.

Mbyllet mbledhja e Kryesisë

Sekretar i Keshillit

Valbona Çela